

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

PUNIME DEKORATIVE DHE
BOJATISJE

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor “NDËRTIM”)

Kodi: B5-III-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë 2022

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK.

III. Plani mësimor për profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve ” për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetpunësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me punimet dekorative dhe të bojatisjes.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në

- përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
 - mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
 - mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
 - mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.

- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin e II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të analizojë, planifikojë dhe kryejë organizimin e vogël të punës në punimet dekorative dhe të bojatisjes.
- Të kryejë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet dekorative dhe të bojatisjes.
- Të planifikojë nevojën e burimeve njerëzore.
- Të ndajë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve.
- Të plotësojë dokumentacionin teknik në punimet dekorative dhe të bojatisjes.
- Të kryejë procese parapërgatitore për punime dekorative dhe të bojatisjes.
- Të kryejë punime dekorative me kartonxhes dhe maskime të instalimeve të ndryshme.
- Të kryejë punime dekorative me kartonxhes të tavaneve të varur.
- Të kryejë punime të elementeve dekorative në mjedise të brendshme (korniza e rozeta tavanesh, etj) e të jashtme (fasada) korniza perimetrale të dritareve.
- Të kryejë punime patinimi me materiale e teknika patinuese të ndryshme në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme (tavan, mur, shtyllë, tra, qemerë, korniza dritarësh, etj) e të jashtme (fasada).
- Të kryejë punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe me suva e pa suva,
- Të kryejë punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe druri, betoni e metali, etj të brendshme e të jashtme (fasada).
- Të kryejë punime bojatisje dekorative të ndryshme.
- Të kryejë punime të veshjes me letër murale dekorative me ngjitje në sipërfaqe të ndryshme.
- Të kryejë punime të veshjes me letër murale dekorative me vetëngjitje (adeziv), 3D dhe e personalizuar.
- Të kryejë punime dekorative të sipërfaqeve me taserina.
- Të kryejë punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe prej tulle e guri të brendshme e të jashtme.
- Të kryejë riparime të mundshme gjatë punimeve dekorative dhe të bojatisjes.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë, të mbrojtjes së mjedisit dhe të MKZ.
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve mbas kryerjes së punimeve dekorative dhe të bojatisjes.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve.
- Të kryejë detyra administrative e tregtare për punime dekorative dhe të bojatisjes.
- Të ngrejë nivelin profesional për punime dekorative dhe të bojatisjes.
- Të komunikojë me etikë profesionale.

– Të përdorë teknologjinë dixhitale në mbështetje të veprimtarisë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje ndërtimi, për t’u vetëpunësuar ose mbas një përvoje pune, të krijojë një biznes të vogël në punimet dekorative dhe të bojatisjes, si dhe të punësojë të tjerë në të.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Plani mësimor për profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK (1 vjeçar)			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-02-413-21	Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative	1
3	L-02-414-21	Teknikë e punimeve dekorative	2
4	L-02-415-21	Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes	1
5	L-02-416-21	Teknikë e konstruksioneve mbajtëse	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-02-1809-21	Punime dekorative me kartonxhes	102
2	M-02-1810-21	Punime të elementeve dekorativë	69
3	M-02-1811-21	Patinime në sipërfaqe të ndryshme	84

4	M-02-1812-21	Bojatisje në sipërfaqe të ndryshme	84
5	M-02-1813-21	Veshja e sipërfaqeve me letër murale	69
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-02-1814-21	Punime dekorative të sipërfaqeve me taserina	102
2	M-02-1815-21	Bojatisje në sipërfaqe prej tulle e guri	102
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimit e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e

tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “*Punime dekorative dhe bojatisje*”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “*Punime dekorative dhe bojatisje*”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “*Ndërtim*”, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Punime dekorative dhe bojatisje”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “*Punime dekorative dhe bojatisje*”, niveli III i KSHK, të drejtimit mësimor “*Ndërtim*”, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK të drejtimit “*Ndërtim*”.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gadishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë marrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.
- të përshkruajë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive në mjedisin e punës.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 – 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë (sjellja) sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	3 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë

Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	3 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gadishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	4 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	4 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë
Tema 19	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedisin e punës	4 orë

2. Lënda “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative” (L-02-413-21). Kl. 12 - 34 orë

• Synimet e lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të lexojnë dhe të vizatojnë detaje arkitektonike dekorative sipas përmasave të dhëna në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të interpretojnë skica nga vizatimet skematike të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz, etj) dhe shenjat dalluese të përdorura;
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së kateve në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të vizatojnë planimetritë e kateve të ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planimetrisë së themeleve dhe prerjeve të tyre në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të vizatojnë planimetrinë e themeleve të ndërtesës dhe prerjet e tyre sipas skicës së dhënë.
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të prerjeve në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të vizatojnë prerjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të pamjeve në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të vizatojnë pamjet e ndërtesës sipas skicës së dhënë;
- Të përshkruajnë fazat e vizatimit të planit të strukturave të ndërkateve në objekte të ndryshme 2 kt;
- Të vizatojnë planit e strukturave të ndërkateve dhe shkallëve, sipas skicës së dhënë;
- Të zërthejnë detaje arkitektonike sipas përmasave të dhëna në planimetri dhe prerje për

- objekte të ndryshme ndërtimi;
- Të zërthejnë vizatimet e punimeve dekorative të mureve të brendshme, të tavaneve të varur, kolonave, trarëve, arkitrarëve, etj.
- Të zërthejnë vizatimet e detajeve të ndryshme në punime dekorative fasadash.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, kl. 12- 34 orë**

Tema 1	Njohuri për vizatimet e ndërtimit dhe shenjat dalluese të përdorura te instalimeve	2 orë
Tema 2	Planimetritë e kateve dhe vizatimi i tyre	6 orë
Tema 3	Planimetria e themeleve, prerjet dhe vizatimi i tyre	5 orë
Tema 4	Prerjet e ndërtesës dhe vizatimi i tyre	6 orë
Tema 5	Pamjet e ndërtesës dhe vizatimi i tyre	4 orë
Tema 6	Planet e strukturave të ndërkateve të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	5 orë
Tema 7	Detajet arkitektonike dhe konstruktive të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	3 orë
Tema 8	Detajet e punimeve dekorative në mjediset e brendshme dhe të jashtme të ndërtesës dhe vizatimi i tyre	3 orë

3. Lënda “Teknikë e punimeve dekorative” (L-02-414-21). Kl. 12 - 68 orë

• **Synimet e lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për punimet dekorative në mure me kartonxhes.
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për punimet dekorative në tavane të varura dhe me materiale veshëse dekorative.
- Të interpretojnë skicat e punimeve dekorative në mjediset të brendshme (mure, tavane të varur, shtylla, trarë, arkitrarë etj).
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna të elementeve dekorative në mjediset të jashtme (fasada).
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna të elementeve dekorative të maskimit të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.)
- Të përshkruajnë llojet e materialeve, mjetet e punës, instrumentet matëse –niveleuse dhe aksesoret për punimet dekorative dhe veshjet me kartonxhes.
- Të përshkruajnë teknikat e veshjes së sipërfaqeve të brendshme me pllaka dekorative sipas skicës.
- Të përshkruajnë teknikat e realizimit të mureve të brendshme me kartonxhes sipas skicës.
- Të përshkruajnë mënyrat e nivelimit të tavaneve të varura.
- Të përshkruajnë teknikat e realizimit të tavaneve të varura dekorative me kartonxhes sipas konfiguracionit në skicë.
- Të përshkruajnë hapat e maskimit të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ventilim, gaz etj.) në ndërtesë sipas skicës.
- Të përshkruajnë teknikat e përgatitjes së sipërfaqeve të brendshme për punime dekorative.

- Të përshkruajnë teknikat e stukimeve në bashkimet midis elementëve për punime dekorative.
- Të përshkruajnë mënyrat e përgatitjes së elementeve dekorative të kolonave, rozetave në tavane, kornizat këndore në bashkimin e murit me tavanin, oxhaqeve etj. sipas skicës.
- Të dallojnë elementet e thjeshta dekorative në objekte dhe të përshkruajnë teknikat e riparimit të tyre.
- Të përshkruajnë teknikat e hapave të riparimeve të elementeve të thjeshta në objekte ndërtimi.
- Të verifikojnë punimet dekorative sipas skicës dhe cilësinë e tyre.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë e punimeve dekorative”, kl.12- 68 orë**

Tema 1	Skicimi për detajet dekorative me kartonxhes për sipërfaqe të ndryshme	8 orë
Tema 2	Skicimi për detajet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme në objekte ndërtimi	8 orë
Tema 3	Skicimi për detajet e maskimit të instalimeve në objekte ndërtimi	6 orë
Tema 4	Teknika dhe hapat e punimeve të mureve me kartonxhes	10 orë
Tema 5	Teknika dhe hapat e punimeve dekorative të sipërfaqeve të ndryshme	12 orë
Tema 6	Teknika dhe hapat e punimeve të elementeve dekorative në objekte ndërtimi	12 orë
Tema 7	Teknika dhe hapat e punimeve dekorative të maskimit të instalimeve në ndërtesë	6 orë
Tema 8	Teknika dhe hapat e punimeve të riparimeve të elementeve të thjeshta në objekte ndërtimi	6 orë

4. Lënda “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes” (L-02-415-21). Kl. 12 - 34 orë

• **Synimet e lëndës “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të nxjerrin të dhënat për punimet e patinimit dhe bojatisjes nga shënimet në projektin e zbatimit.
- Të nxjerrin të dhënat për punimet e veshjes së mureve me letër murale e tekstile nga shënimet në projektin e zbatimit.
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna për patinim dhe bojatisjes në sipërfaqet e të brendshme e të jashtme.
- Të interpretojnë skica me përmasa të dhëna për veshje të mureve me letër murale e tekstile në sipërfaqet e mureve të brendshme e tavaneve.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e patinimit të sipërfaqeve të brendshme te jashtme.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e patinimit e sipërfaqeve me kartonxhes.
- Të interpretojnë skicat me përmasa të dhëna për bojatisje në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e bojatisjes në sipërfaqe të brendshme dhe

të jashtme.

- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e bojatisjes së elementeve dekorative në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e bojatisjes së elementëve të parapërgatitur.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e ndryshme të patinimit në sipërfaqe të suvatuara dhe pasuvatuara
- Të përshkruajnë teknikat e hapave të bojatisjes në sipërfaqe të suvatuara dhe pasuvatuara.
- Të përshkruajnë teknikat e hapave të bojatisjes në sipërfaqe druri, metali, betoni, tulle e guri.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e veshjes me letër murale e tekstile të sipërfaqeve të suvatuara të mureve të brendshme e tavaneve.
- Të përshkruajnë hapat dhe teknikat e riparimeve të patinimit dhe bojatisjes në objekte ndërtimi.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “ Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes”, kl.12- 34 orë**

Tema 1	Nxjerrja e të dhënave për punimet e patinimit dhe bojatisjes nga shënimet në projekt	2 orë
Tema 2	Nxjerrja e të dhënave për punimet e e veshjes së mureve me letër murale e tekstile nga shënimet në projekt	2 orë
Tema 3	Teknika e përpunimit të sipërfaqeve të suvatuara të mureve të brendshme, të jashtme dhe tavane me kartonxhes dhe elemente dekorative	4 orë
Tema 4	Teknika e punimit të patinimit të sipërfaqeve të suvatuara të mureve të brendshme, të jashtme dhe tavane me kartonxhes dhe elemente dekorative	10 orë
Tema 5	Teknika e punimit të bojatisjes të sipërfaqeve të suvatuara të mureve të brendshme e të jashtme dhe tavane me kartonxhes dhe elemente dekorative me materiale të ndryshme	10 orë
Tema 6	Teknika e punimit të bojatisjes në mure të ndryshme me lloje të ndryshme bojrash	2 orë
Tema 7	Teknika e punimit të veshjes me letër murale e tekstile të llojeve të ndryshme në sipërfaqe muresh të suvatuara	2 orë
Tema 8	Teknika e punimit të riparimeve të patinimit dhe bojatisjes në mure	2 orë

5. Lënda “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse” (L-02-416-21). Kl. 12 - 34 orë

- **Synimet e lëndës “ Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të rendisin llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave sipas skemave konstruktive.
- Të përshkruajnë elementet konstruktive përbërëse të konstruksioneve prej betoni të armuar.
- Të interpretojnë skica konstruktimi të elementeve të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.

- Të interpretojnë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit (F_a) për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar.
- Të përcaktojnë numrin dhe diametrin (n dhe \emptyset) të shufrave për sipërfaqen F_a të dhënë për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar me përmasa të dhëna.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllaka monolite prej betoni të armuar me një fushë dhe me konsola, si dhe pllakë të vazhduar me dy fusha.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për trarë monolitë prej betoni të armuar me një fushë dhe me konsola, si dhe trarë të vazhduar me dy fusha.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për pllakë të përzier me trarë prej betoni të armuar dhe mbushje me tulla me vrima me një fushë.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për plint të shkallëzuar, pllakë dhe trarë monolit prej betoni të armuar të themeleve dhe shtylla monolite prej betoni të armuar dykatëshe me prerje katrore.
- Të skicojnë shufrat e hekurit të gjetura, sipas modelit të dhënë për shkallë monolite prej betoni të armuar me një dhe dy rampa.
- Të hartojnë tabelën e specifikimit të armaturës së hekurit për elementet e mësipërme prej betoni të armuar.
- Të përshkruajnë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura e gjysmë të parapërgatitura.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle.
- Të përshkruajnë llojet konstruksioneve mbajtëse prej druri e metali.

**Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “ Teknologji konstruksioneve mbajtëse”,
kl.12- 34 orë**

Tema 1	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive të tyre	2 orë
Tema 2	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje	6 orë
Tema 3	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në shtypje	6 orë
Tema 4	Parimet bazë për konstruktimin e themeleve prej betoni të armuar	6 orë
Tema 5	Parimet bazë për konstruktimin e shkallëve prej betoni të armuar	6 orë
Tema 6	Konstruksionet prej betoni të armuar me elemente të parapërgatitura e gjysmë të parapërgatitura	4 orë
Tema 7	Konstruksionet prej guri e tulle	2 orë
Tema 8	Konstruksionet prej druri e metali	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punime dekorative me kartonxhes”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME DEKORATIVE ME KARTONXHES	M-02-1809-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit të kryejnë punime dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve të ndryshme (tavaneve, mureve ndarëse, të mureve ekzistuese, maskime të instalimeve të ndryshme, etj)	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin dhe detajet e elementeve me aksesorët përkatës me kartonxhes;– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet dekorative me kartonxhes;– të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në punime dekorative me kartonxhes;– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, instrumentet dhe pajisjet e punës sipas proceseve të punës;– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve dekorative me kartonxhes;– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve dekorative me kartonxhes; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli	
	<p>RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore Kriteret e vlerësimit:</p>	

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës për punimet dekorative me kartonxhes;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të interpretojnë mënyrat dhe teknikat të ndryshme për punimet dekorative me kartonxhes;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës në punime dekorative me kartonxhes;
- të shënojnë koordinatat dhe kuotat e konstruksionit të murit dhe tavanit me kartonxhes sipas fletës projektit;
- të kontrollojnë rrafshhtësinë e sipërfaqeve me instrumentet e kontrollit dhe të shënojnë kuotat horizontale të tavanit me kartonxhes sipas skicës;
- të bëjnë matjet e shënojnë në sipërfaqe pozicionimin e strukturës në kuotat përkatëse sipas detajit të dhënë;
- të parapërgatisin elementet e skeletit metalik me profile për sipërfaqe të ndryshme (tavanin dhe të dy anët e murit dhe për hapësirat dyer – dritare etj) sipas përmasave në skicën e dhënë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit kryejnë punime dekorative me kartonxhes në sipërfaqe të ndryshme.

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të vendosin ganxhat e gatshme në tavanin ekzistues për fiksimin e skeletit metalik;
- të montojnë duke fiksuar elementet për formimin e skeletit me aksesorët përkatës në sipërfaqet ekzistuese (mur, shtyllë, tra, tavan, dysheme);
- të kontrollojnë me instrumente matëse e niveluese elementet e montuar/fiksuar;
- të vendosin kapset bashkuese në pikat e kryqëzimit të profileve;
- të përgatisin panelet kartonxhes në tavan, mur etj. sipas detajeve në fletën e projektit;
- të montojnë panelet kartonxhes në tavan, mur etj. sipas radhës punës;
- të përgatisin dhe fiksojnë shtresën termoizoluese në mes të murit, etj sipas kushteve teknike;
- të kryejnë hapjen e vrimave për instalimet e kutive elektrike etj;
- të fiksojnë këndoret e gatshme (mur, dyer – dritare) sipas kushteve teknike;
- të stukojnë rretjen për mbulimin e fugave të kartonxhesit dhe vrimat e vidave, upave, etj sipas

- kushteve teknike;
- të kryejnë riparime të mundshme gjatë punimit të sipërfaqeve me kartonxhes;
 - të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës sipas fletës projektit;
 - të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
 - të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
 - të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të sipërfaqeve me kartonxhes;
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas punimeve të sipërfaqeve me kartonxhes;
 - të sistemojnë vendin e punës pas punimit të sipërfaqeve me kartonxhes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve në punimet dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës në punimet dekorative me kartonxhes, kryerjen e veprimeve parapërgatitore, përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të kryejnë punime dekorative me kartonxhes në sipërfaqe të ndryshme dhe respektojnë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ duke u mbikëqyrur nga mësuesi praktikës.
- Nxënësit duhet kryejnë riparime të mundshme gjatë punimit të sipërfaqeve me kartonxhes si dhe detyra administrative dhe tregtare në punime dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për organizimin e vogël të punës në punimet dekorative me kartonxhes, kryerjen e veprimeve parapërgatitore , përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese, në kryerjen dhe riparimin e punimeve dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve të ndryshme.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis dhe objekt pune ndërtimi.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.
-

-
- Pankarta për punimet dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve dhe detajet e aksesorët e tyre.
 - Fletët e projektit të instalimeve elektrike, hidrosanitare, ngrohje-ventilim e audio-vizive etj.
 - Kompletet e mjeteve të punimeve të kartonxhesit.
 - Instrumentet matëse e niveluese.
 - Kompletet e veshjes së punës.
 - Materialet në punimet dekorative me kartonxhes të sipërfaqeve:
 - Panele kartonxhes të llojeve të ndryshme,
 - Profile metalike, upa, vida, lima, sharrë, pinca, çekiç, kaçavidë.
 - Aksesorë të ndryshëm për skeletin dhe fiksimin e tij,
 - Ganxha e këndore të gatshme, rrjetë vetëngjithëse,
 - Stuko patinimi, mallë ,mistri, lopata, f shirëse ,shënues.
 - Makineri prerëse.
 - Skela të gatshme, shkallë bojaxhiu .
 - Manuallet e preventivimit dhe për zbrëthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit
-

2. Moduli “Punime të elementeve dekorativë”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË ELEMENTEVE DEKORATIVË	M-02-1810-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme (korniza e rozeta tavanesh, etj) e të jashtme (korniza perimetrale të dritareve në fasadë).	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer Për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e elementeve dekorative me aksesoret përkatës në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada);– të rendisin proceset e nevojshme për punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada);– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada);– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;– të planifikojnë mjetet dhe pajisjet e punës;– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punës në punimet dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada);– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada). Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli	

RM 2 Nxënësit kryejnë procese parapërgatitore

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të përzgjedhin mjetet,veglat dhe materialet e punës sipas procesit të punës;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve,veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të kontrollojnë horizontalitetin e brinjëve perimetrale të tavanit për vendosjen e elementeve të p/përgatitur dekorative prej gipsi;
- të masin përmasat e vendeve ku do kryhen punimet dekorative prej gipsi;
- të kontrollojnë rrafshtësinë e sipërfaqes së tavanit dhe me instrumente matëse-niveluese, në vendin ku do të vendoset rozeta;
- të masin, shënojnë në sipërfaqet përkatëse vendin e fillimit të punimeve sipas skicës;
- të interpretojnë teknikat që do të përdoren për kryerjen e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato;
- të interpretojnë hapat e punimeve të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato;
- të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM3 Nxënësit kryejnë punime të elementeve dekorativë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin materialin ngjitës sipas materialit të kornizave dhe rozetës së tavanit;
- të ngjisin kornizat në brinjët perimetrale të tavanit duke i përputhur ato me sipërfaqet takuese;
- të ngjisin rozetën duke e përputhur atë me sipërfaqen e tavanit në bashkëpunim me specialistin përkatës;
- të përgatisin kallëp – shabllonin për kornizën perimetrale të dritares në fasadë sipas konfiguracionit të dhënë në skicë, si dhe ta fiksojnë atë sipas kushteve teknike;
- të përgatisin materialin mbushës (allçi, llaç, etj) për kornizën perimetrale sipas llojit (allçi, llaç etj) dhe recepturave të përcaktuara në projekt;
- të mbushin kallëp – shabllonin me materialin e përgatitur, duke respektuar kushtet teknike sipas llojit të

- tij dhe trashësisë së shtresës mbushëse;
- të heqin me kujdes pas ngurtësimit të materialit mbushës (allçi, llaç etj) kallëp - shabllonin për kornizën perimetrale të dritares në fasadë;
 - të përpunojnë sipërfaqen e kornizës perimetrale të dritares në fasadë sipas hollësive të dhëna në projekt;
 - të kryejnë riparime të mundshme në vendet dekorative në korniza, rozetë tavani e të sipërfaqes së kornizës perimetrale të dritares në fasadë etj, sipas kushteve teknike;
 - të kryejnë kontrollin përfundimtar të realizimit të detyrës;
 - të sigurojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara sipas standardeve;
 - të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
 - të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të elementeve dekorative;
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas punimeve dekorative;
 - të sistemojnë vendin e punës pas punimeve dekorative.
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekte ndërtimi dhe rapart ndërtimi.
 - Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës dhe kryerjen e veprimeve parapërgatitore në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), si dhe për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
 - Nxënësit duhet të kryejnë punime të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), respektojnë rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve.
 - Nxënësit duhet kryejnë detyra administrative dhe tregtare në punime të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore në punimet e elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese, kryerjen e punimeve të elementeve dekorative në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada) duke respektuar rregullat e sigurimit teknik,
-

të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve, si dhe kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune dhe objekt ndërtimi.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
 - Pankarta për punimet e elementeve dekorative (korniza e rozeta tavani dhe korniza perimetrale në dritare në fasadë) me detajet e tyre
 - Kompletet e mjeteve të muratorit dhe bojaxhiut.
 - Instrumentet matëse e niveluese.
 - Kompletet e veshjes së punës.
 - Materialet për realizimin e elementeve dekorative:
 - Korniza tavani të (parapërgatitura) gatshme me profile dhe materiale të ndryshme (allçi, polisterol etj),
 - Rozeta tavani të (parapërgatitura) gatshme me konfiguracione, profile dhe materiale të ndryshme (allçi, polisterol etj),
 - Rërë, granil i hollë, çimento, gëlqere, ujë,
 - Ngjitës, stuko patinimi, upa etj
 - Kubik
 - Dërrasa për kallëp - shabllon, gozhdë,
 - Skela të gatshme, shkallë bojaxhiu.
 - Manualet e preventivimit për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit
-

3. Moduli “Patinime në sipërfaqe të ndryshme”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PATINIME NË SIPËRFAQE TË NDRYSHME	M-02-1811-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e patinimit në sipërfaqe me suva e pa pasuva, në mjedise të brendshme (tavan, mur, shtyllë, tra, korniza dritaresh, etj) e të jashtme mur e tavan ballkoni.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer Për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet, skicat e sipërfaqeve të suvatuara e të pasuvatuar në mjedise të brendshme e të jashtme;– të rendisin proceset e nevojshme për punimin e patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme;– të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve për punimet e patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme;– të planifikojnë nevojën e burimeve njerëzore;– të planifikojnë mjetet dhe pajisjet e punës për punime patinimi;– të përcaktojnë radhën e kryerjes së punës në punimet e patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme;– të ndajnë detyrat e punës sipas grafikut të punimeve;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojnë punën me grupet e proceseve të tjera punës;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e patinimit në sipërfaqe me suva e pa pasuva në mjedise të brendshme e të jashtme. Instrumentet e vlerësimit:	

RM 2 Nxënësit kryejnë punimet parapërgatitore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të përzgjedhin mjetet, instrumentet dhe materialet e punës sipas procesit të punës;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të përcaktojnë stukon e patinimit sipas llojit të sipërfaqeve;
- të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë;
- të vendosin me saktësi letrën ngjitëse mbrojtëse në kufirin e sipërfaqes që patinohet me objektet e tjera (kornizat e dyer – dritareve, davancaleve, plintusave, prizave etj);
- të interpretojnë teknikat që përdoren për kryerjen e patinimit në sipërfaqe me suva dhe pa suva në mjediset të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato;
- të lagin e pastrojnë nga pluhurat sipërfaqet me suva e pa pasuva në mjediset e brendshme (tavane, mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj) dhe në mjediset e jashtme (mure e tavane ballkonesh) sipas kushteve teknike;
- të kryejnë pastrimin paraprak të mjedisit ku do të punojnë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit patinojnë në sipërfaqe të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin stukon e patinimit me ujë;
- të shtrojnë stukon e patinimit në sipërfaqe me suva;
- të patinojnë sipërfaqet në mjediset e brendshme me suva (mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj) dhe të jashtme (mure e tavane ballkonesh) sipas kushteve teknike;
- të smerilojnë zonat e patinuara në mure me suva sipas kushteve teknike;
- të vendosin dhe stukojnë rrjetën midis fugave, upave dhe zonave të dëmtuara të sipërfaqeve pa suva në mjediset e brendshme dhe të jashtme sipas kushteve teknike;
- të përgatisin materialin patinues për llojin e murit pasuva;
- të shtrojnë materialin e patinimit në sipërfaqet pasuva sipas kushtit teknik;
- të patinojnë sipërfaqet në mjediset e brendshme pa suva (mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj) dhe të

- jashtme (mure e tavane ballkonesh) sipas kushteve teknike;
- të kontrollojnë rrafshhtësinë e sipërfaqes së patinuar me instrumente matëse e niveluese;
 - të smerilojnë zonat e patinuara në mure pa suva sipas kushteve teknike;
 - të kryejnë pastrimin sipërfaqeve mbas zmerilimit të patinimit të tyre;
 - të lyejnë me astar të gatshëm sipërfaqet e patinuara me suva e pasuva;
 - të heqin me kujdes letrën ngjytëse mbrojtëse dhe të pastrojnë sipërfaqet e plintusave, dyshemesë, davancaleve, dyer – dritareve, parapeteve etj
 - të riparojnë sipërfaqet ekzistuese të patinuara sipas kushteve teknike;
 - të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
 - të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të patinimit;
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme dhe të jashtme;
 - të sistemojnë vendin e punës pas punimit të patinimit në sipërfaqe me suva e pasuva në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekte ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve të patinimit në sipërfaqe me suva e pasuva.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin , planifikimin ,organizimin e vogël të punës dhe kryerjen e veprimeve parapërgatitore në punimet patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme
- Ata/ato duhet të përdorin drejt instrumentet matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të kryejnë patinime në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada) duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve.
- Nxënësit duhet të kryejnë detyra administrative dhe tregtare në punimet e patinimit në sipërfaqe me suva e pa suva në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada).
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës , kryerjen e veprimeve përgatitore në punimet patinimit në sipërfaqe me suva e pasuva në mjedise të brendshme e të jashtme,verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike të përdorimit të mjeteve të punës për punimin e patinimit në sipërfaqe me suva e pasuva në mjedise të brendshme dhe të jashtme, si dhe kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis dhe objekt pune ndërtimi.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
 - Pankarta për punimet e patinimit të sipërfaqeve
 - Komplet i mjeteve të patinimit, (mallë, kovë, furçë, shpatulla metalike etj).
 - Instrumentet matëse e niveluese.
 - Komplet i veshjes punës së bojaxhiut.
 - shkallët e bojaxhiut
 - Materialet për patinimin:
 - Ujë, ngjyrues
 - Materiale të ndryshme patinimi, rrjeta
 - Katalogu i materialeve patinuese,
 - Astar për lyerjen e sipërfaqeve të patinuara,
 - Letër ngjytëse mbrojtëse për kufizimin e sipërfaqeve që patinohen,
 - Stuko të ndryshme patinimi, zmerilues.
 - Skela të gatshme, rrjeta mbrojtëse.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit
-

4. Moduli “Bojatisje në sipërfaqe të ndryshme”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	BOJATISJE NË SIPËRFAQE TË NDRYSHME	M-02-1812-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe me suva e pa suva, të brendshme e të jashtme (fasada); në punime bojatisje me materiale e teknika bojatisje të ndryshme në sipërfaqe prej druri, betoni e metali.	
Kohëzgjatja e modulit	84 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer Për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e bojatisjes në sipërfaqe me suva e pa suva të brendshme e të jashtme (fasada) dhe prej druri, betoni e metali;– të kryejnë matjet e sipërfaqeve që do lyhen;– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, veglat e punës të nevojshme;– të planifikojnë nevojën për burime njerëzore sipas grafikut të punimeve;– të ndajnë detyrat e punës sipas radhës;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojë punën me grupet e punës të proceseve tjera;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të bojatisjes në sipërfaqe me suva e pa suva të brendshme e të jashtme (fasada) dhe prej druri, betoni e metali. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Nxënësit kryejnë punimet parapërgatitore

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të përzgjedhin mjetet, instrumentet dhe materialet e punës sipas procesit të punës;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës;
- të sigurojnë ndriçimin dhe ajrosjen e duhur të vendit të punës;
- të vendosin me saktësi letrën ngjytëse mbrojtëse në kufirin e bojatisjes midis dy sipërfaqeve me ngjyra të ndryshme dhe objekteve që nuk do të bojatisen;
- të pastrojnë nga pluhurat sipërfaqet e suvatuara e pasuvatuara / patinuara në mjediset e brendshme (tavane, mure, shtylla, trarë, korniza të dritareve etj.) dhe fasadë sipas kushteve teknike;
- të kryejnë riparimet me stuko në sipërfaqet e suvatuara e pasuvatuara,
- të kryejnë zmerilimin e sipërfaqeve të stukuara me suva e pasuva,
- të lyejnë me astar të gatshëm sipërfaqet me suva e pa suva që do të lyhen,
- të pastrojnë sipërfaqet e metalit, drurit e betonit sipas kushteve teknike,
- të interpretojnë teknikat të ndryshme që përdoren për kryerjen e bojatisjes në sipërfaqe me suva, pa suva, druri, betoni e metali në mjedise të brendshme e të jashtme (fasada), duke i specifikuar ato,
- të pastrojnë paraprakisht vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit kryejnë bojatisje në sipërfaqe të ndryshme

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përziejnë bojën e parapërgatitur sipas llojit të sipërfaqes dhe kërkesës së klientit;
- të lyejnë sipërfaqet me bojën bazë të bardhë;
- të bojatisin tavanin në mjedisin e brendshëm dhe të jashtme ballkon me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, sipas kushteve teknike në sipërfaqe suvaje e josuvaje;
- të kryejnë prerjen e kufirit të bojatisjes midis dy sipërfaqeve me ngjyra të ndryshme dhe objekteve që nuk do të bojatisen, sipas kushteve teknike në ambiente të brendshme e të jashtme në sipërfaqe suvaje e josuvaje;

- të bojatisin me bojën e parapërgatitur sipas standarteve sipërfaqet e brendshme (muret, shtyllat, trarët, kornizat e dritareve etj);
- të bojatisin me bojën përkatëse fasadën me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, sipas katalogut në sipërfaqe me suva e pa suva;
- të stukojnë me rezinë sipërfaqen prej druri e metali në zonat e dëmtuara;
- të smerilojnë plotësisht sipërfaqen prej druri e metali sipas kushteve teknike;
- të pastrojnë dhe thajnë sipërfaqen e jashtme prej druri
- të lyejnë me furçë me vaj special (dylli) për të mbrojtur sipërfaqen nga agjentët atmosferikë;
- të lyejnë sipërfaqet prej druri e metali me llak me bazë uji (aqualux-rezinë akrilike) të gatshme;
- të lyejnë sipërfaqet prej metali me bojë kundra ndryshkut sipas kushteve teknike me dorën e parë e pas tharjes së saj me dorën e dytë, sipas llojit;
- të pastrojnë dhe thajnë sipërfaqen prej betoni që do lyhet;
- të lyejnë sipërfaqet prej betoni me primer/astar (grimca-kuarci) për të formuar një shtresë të ashpër;
- të lyejnë sipërfaqet prej betoni me bojë epokside(mbrojtës i sipërfaqeve të betonit);
- të mirëmbajnë pas lyerjes sipërfaqet prej betoni;
- të heqin me kujdes letrën ngjitëse mbrojtëse dhe të pastrojnë sipërfaqet e plintusave, dyshemesë, davancaleve, xhamave të dyer – dritareve, parapeteve etj;
- të riparojnë sipërfaqet ekzistuese të bojatisura sipas kushteve teknike;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës për punimet e bojatisjes në sipërfaqe me suva e pa suva, druri, betoni e metali në ambiente të brendshme e të jashtme;
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të bojatisjes në sipërfaqe me suva e pa suva, druri, betoni e metali.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Nxënësit kryejnë bojatisje dekorative

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të kontrollojnë dhe shënojnë sipërfaqen për bojatisje dekorative;
- të ndajnë sipërfaqet për dekorim nga pjesa tjetër sipas

- projektit;
- të përgatisë shabllonet e duhura për dekorim;
 - të kryejë bojatisjen bazë në sipërfaqet e ndryshme;
 - të kryejë bojatisjen dekoruese me shabllonin përkatës;
 - të përgatisë stukon përkatëse dekorative sipas llojit(stuko veneciane,stuko imitime mermri,metali,mëndafshi etj);
 - të stukojnë mbi sipërfaqet e caktuara sipas llojit;
 - të formojë me vegla dore(rul dekorativ,furçë,leckë etj) figura të ndryshme sipas projektit;
 - të heqin me kujdes letrën ngjitime mbrojtëse dhe të pastrojnë sipërfaqet e plintusave, dyshemesë, davancaleve, xhamave të dyer – dritareve, parapeteve etj;
 - të riparojnë sipërfaqet ekzistuese të bojatisura sipas kushteve teknike;
 - të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
 - të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;
 - të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas punimeve të bojatisjes dekorative;
 - të sistemojnë vendin e punës, hermetizojnë holluesit dhe bojrat e përdorura pas bojatisjes dekorative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekte ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete për lyerjen e sipërfaqeve me suva e pa suva të brendshme e të jashtme (fasada) prej, druri, betoni e metali.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës , përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për lyerjen e sipërfaqeve me suva e pa suva të brendshme e të jashtme (fasada) prej, druri,betoni e metali dhe lyerjen dekorative duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ.
- Nxënësit duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare në punimet bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada) prej, druri betoni e metali.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike në analizimin , planifikimin, organizimin e vogël të punës, të përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve të punës për punimet e bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme (fasada) prej, druri, betoni e metali, lyerjen dekorative duke respektuar rregullat e sigurimit

teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ, si dhe kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis dhe objekt pune ndërtimi.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit,
 - Pankarta për punimet e bojatisjes dekorative, sipërfaqeve me suva e pa suva të mjediseve të brendshme e fasadave prej druri, betoni e metali me detajet e tyre
 - Komplet i mjeteve të bojaxhiut
 - Instrumentet matëse e niveluese.
 - Komplet i veshjes së punës bojaxhiut
 - Materialet për lyerjen e sipërfaqeve dekorative, me suva e pa suva, druri, betoni e metalike.
 - Astar i gatshëm për lyerjen e sipërfaqeve të patinuara të mjediseve të brendshme (mure, tavane, shtylla, trarë etj) dhe fasadave
 - Vaj special (dylli) bojë epokside (mbrojtës i sipërfaqeve të betonit)
 - Katalogu i bojërave për bojatisjen e sipërfaqeve me suva e pa suva të mjediseve të brendshme dhe fasadave,
 - Bojëra e pigmente të ndryshme për bojatisjen e sipërfaqeve me suva e pa suva të mjediseve të brendshme dhe fasadave,
 - Bojëra të ndryshme për bojatisjen e sipërfaqeve prej betoni,
 - Bojëra rezine për bojatisjen e sipërfaqeve të përpunuara prej druri.
 - Bojëra kundër ndryshkut për bojatisjen e sipërfaqeve prej metali.
 - Letër ngjytëse mbrojtëse për kufizimin e sipërfaqeve që bojatisen.
 - Stuko patinimi, zmerilues shënues.
 - Skela të gatshme e shkallë bojaxhiu.
 - Kompjuter me programin e përgatitjes së bojërave.
 - Manuallet e preventivimit dhe për zberthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit që lidhet me punimet e bojatisjes
-

5. Moduli “Veshja e sipërfaqeve me letër murale”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VESHJA E SIPËRFAQEVE ME LETËR MURALE	M-02-1813-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punimet e veshjes së sipërfaqeve të ndryshme me letër murale me ngjitje e vetngjitje adeziv (3D, e personalizuar, etj)	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer Për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet e skicat e elementeve të veshjes me letër murale me ngjitje e vetngjitje adeziv(3D, e personalizuar etj);– të kryejnë matjet e sipërfaqeve që do punohet;– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, veglat e punës të nevojshme;– të planifikojnë nevojën për burime njerëzore sipas grafikut të punimeve;– të ndajnë detyrat e punës sipas radhës;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojë punën me grupet e punës të proceseve tjera;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të veshjes së sipërfaqeve me letër murale. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>RM 2 Nxënësit kryejnë punime parapërgatitore <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;– të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike;	

- të interpretojnë saktë kodet e llojeve të letrave murale dhe ngjitësit përkatës;
- të interpretojnë saktë mënyrat e përdorimit të letrave murale dhe ngjitësit sipas instruksionit përkatës;
- të përcaktojnë llojin e letrës murale sipas llojit sipërfaqeve dhe kërkesës;
- të kontrollojnë sipërfaqen që do të vishet (tavan, mur, davançal, shtyllë, tra etj) me instrumentet matëse dhe niveluese;
- të smerilojnë sipërfaqen që do të vishet dhe ta pastrojnë atë nga pluhurat sipas kushteve teknike;
- të interpretojnë teknikat të ndryshme që përdoren për kryerjen veshjen e sipërfaqeve me letër murale me ngjitës dhe me vetëngjitje (adeziv), 3D,e personalizuar etj;
- të pastrojnë paraprakisht vendin e punës;
- të kryejnë vijëzimet në sipërfaqet që do të vishet .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit veshin sipërfaqet me letër murale me ngjitës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të masin përmasat e sipërfaqes që do të vishet, t’i shënojnë ato në letrën murale të radhës së parë, të radhës së dytë, etj dhe ta presin atë me saktësi sipas konfigurimit real të sipërfaqes dhe dekoracionit të letrës;
- të lyejnë sipërfaqen që do të vishet me materialin ngjitës sipas kushteve teknike;
- të ngjisin në sipërfaqe dhe ta ngjeshin letrën murale për radhën e parë, për radhën e dytë, etj sipas kushteve teknike;
- të pastrojnë ngjitësin e tepërt me leckë të thatë;
- të masin, shënojnë dhe presin letrën murale për pjesët plotësuese dhe të aksesorëve të ndryshëm, me saktësi sipas konfigurimit real të sipërfaqes dhe dekoracionit të letrës;
- të ngjisin dhe ngjeshin letrën murale në sipërfaqet plotësuese dhe të aksesorëve të ndryshëm sipas kushteve teknike;
- të kryejnë riparimet e mundshme për veshjen e sipërfaqeve me letër murale me ngjitës;
- të pastrojnë të gjithë sipërfaqen e veshur me letër murale sipas kushteve teknike;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas veshjen së sipërfaqeve me letër murale;
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të veshjes së

sipërfaqeve me letër murale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Nxënësit veshin sipërfaqet me letër murale dekorative.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të stukojnë sipërfaqet e suvatuara / patinuara në mjedise të brendshme dhe në fasadën që do të vishet me letër murale sipas kushteve teknike;
- të smerilojnë zonat e stukuara dhe pastrojnë sipas kushteve teknike;
- të kryejnë vijëzimet në sipërfaqet që do të vishet;
- të përgatisin letrën murale dekorative vetëngjijtje (adeziv) 3D dhe e personalizuar;
- të vendosin duke e ngjeshur në sipërfaqe letrën murale me vetëngjijtje (adeziv) 3D, dhe e personalizuar sipas kërkesës;
- të presin sipas matjeve letrën murale dekorative vetëngjijtje (adeziv) 3D dhe e personalizuar;
- të vendosin duke e ngjeshur në sipërfaqet bosh letrën murale vetëngjijtje (adeziv) 3D, dhe e personalizuar;
- të pastrojnë të gjithë sipërfaqen e veshur me letër murale 3D e me vetngjijtje etj sipas kushteve teknike;
- të riparojnë sipërfaqet ekzistuese të patinuara sipas kushteve teknike;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;
- të sistemojnë vendin e punës pas punimit të veshjes sipërfaqeve me letër murale me vetëngjijtje (adeziv) 3D e personalizuar etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt dhe repartin e ndërtimit.
- Mësuesi i i praktikës, duhet të përdor demonstrime konkrete të proceseve në punimet e veshjes dekorative me letër muri me ngjijtje dhe 3D, vetngjijtje (adeziv) të personalizuar etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore për veshjen e sipërfaqeve me letër murale me ngjites dhe me vetëngjijtje (adeziv) 3D, e personalizuar ,etj
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në punimet e veshjes dekorative me letër muri me ngjijtje, 3D, vetngjijtje (adeziv), të personalizuar etj duke u mbikëqyrur

nga mësuesi i praktikës në respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese si dhe detyrave administrative dhe tregtare.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike në analizimin , planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, kryerjen e veprimeve parapërgatitore, në kryerjen e e veshjve dekorative me letër muri me ngjitje dhe 3D,vetngjitje (adeziv)të personalizuar etj, respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ, mirëmbajtjen e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese si dhe detyrat administrative dhe tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pune dhe objekte me sipërfaqe që vishen me letër murale të llojeve të ndryshme.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.
 - Pankarta dhe skica për punimet e veshjes sipërfaqeve me letër murale me ngjitje dhe 3D,vetngjitje (adeziv) të personalizuar ,etj me detajet e tyre.
 - Kompletet e veglave dhe instrumentet matëse e niveluese të bojaxhiut.
 - Kompletet e veshjes së punës së bojaxhiut.
 - Materialet për realizimin e punimit të veshjes sipërfaqeve letër murale me ngjitje dhe 3D,vetngjitje (adeziv) të personalizuar etj:
 - Letër murale me trashësi dhe përbërje të ndryshme me ngjitje,
 - Ngjitës letër murale, shpatull gome për ngjeshje letër murale
 - Letër murale me vetngjitje (adeziv) 3D, të personalizuar etj,
 - Stuko patinimi, zmerilues, prerës letre,shirit mbrojtës
 - Astar, ujë, shënues, metër, furçë, kovë, leckë pastrimi,
 - Skela të gatshme, shkallë bojaxhiu.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Punime dekorative të sipërfaqeve me tesarina”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME DEKORATIVE TË SIPERFAQEVE ME TESERINA	M-02-1814-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për punimin dekorativ i sipërfaqeve me tesarina.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK ne drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, detajet, skicat e konfiguracionet dekorative të sipërfaqeve me tesarina;– të kryejnë matjet e sipërfaqeve që do punohen;– të planifikojnë bazën materiale, mjetet,veglat e punës të nevojshme;– të planifikojnë nevojën për burime njerëzore sipas grafikut të punimeve;– të ndajnë detyrat e punës sipas radhës së punimeve;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojnë punën me grupet e punës të proceseve të tjera;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve dekorative të sipërfaqeve me tesarina. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli	

RM 2 Nxënësit kryejnë punime parapërgatitore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;
- të përgatisin vendin e punës, të përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës sipas kushteve teknike;
- të përzgjedhin llojet e taserinave sipas konfiguracionit;
- të interpretojnë saktë mënyrat e ndryshme të konfigurimit me taserina;
- të hedhin në letër konfiguracionin e punimeve me taserina;
- të kontrollojnë sipërfaqen që do të punohet me taserina me instrumentet matëse dhe niveluese;
- të përpunojnë sipërfaqet që do të vishen dhe ta pastrojnë atë nga pluhurat sipas kushteve teknike;
- të kryejnë vijëzimet në sipërfaqet që do të punohet;
- të përgatisin shabllonin e skemës dekorative sipas skicës;
- të shtrijnë letrën horizontalisht dhe vendosin shabllonin sipas skicës;
- të interpretojnë teknikat të ndryshme që përdoren për kryerjen e punimeve dekorative të sipërfaqeve me taserina;
- të pastrojnë paraprakisht vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit kryejnë punime dekorative me taserina

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisin materialin ngjitës dhe ta bojatisin letrën brenda kontureve të skemës dekorative;
- të ngjisin taserinat në letër me konfiguracionin sipas skicës;
- të përgatisin materialin ngjitës dhe ta lyejnë sipërfaqen për ngjitjen e letrës me taserina në sipërfaqe;
- të ngrejnë letrën me taserina dhe ta ngjisin atë në sipërfaqe;
- të ngjeshin sipërfaqen e punuar me taserinat me vegla dore;
- të lagin letrën me ujë në sipërfaqe pas tharjes dhe ta shkëpusin atë nga taserinat sipas kushteve teknike;
- të mbushin fugat e taserinave me bojakun përkatës dhe të pastrojnë sipërfaqen me kujdes nga mbetjet;
- të kryejnë riparimet e mundshme në punimet dekorative me taserina në sipërfaqe të ndryshme;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;
- të pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetet e punës pas punimeve dekorative me taserina në sipërfaqe;
- të sistemojnë vendin e punës pas ngjitjes së letrës me taserina në sipërfaqe.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit.
- Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për punime dekorative në sipërfaqe të ndryshme me taserina.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës, punimet parapërgatitore për punime dekorative në sipërfaqe me taserina, përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Ata/ato si duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune në kryerjen e punimeve dekorative të sipërfaqeve me taserina duke u mbikëqyrur nga mësuesi i praktikës respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit e MKZ.
- Nxënësit duhet të angazhohen në detyra administrative e tregtare lidhur me punimin dekorativ në sipërfaqe me taserina,
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në analizimin, planifikimin, organizimin e vogël të punës, punimet parapërgatitore për punime dekorative në sipërfaqe me taserina, përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese, të kryerjes e punimeve dekorative të sipërfaqeve me taserina, respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ si dhe kryerjen e detyrave administrative e tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis pune ndërtimi.
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit
 - Pankarta për punime dekorative në sipërfaqe të ndryshme me taserina.
 - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
 - Komplet i veshjes punës.
 - Materialet për punime dekorative në sipërfaqe të ndryshme me taserina:
 - Taserina të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme,
 - Letër e veçantë për ngjytjen e taserinave,
 - Mjete shënimi dhe pastrimi,
 - Ngjytës për taserinat në letër,
-

-
- Ngjitës për ngjitjen e taserinave sipërfaqe.
 - Bojak taserinash për fugat.
 - Vegla për prerjen e shabllonit.
 - Skelë e gatshme,shkallë bojaxhiu.
 - Manualet e preventivimit dhe për koston e punimeve.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e ndërtimit
-

2. Moduli “Bojatisje në sipërfaqe prej tulle e guri”

Drejtimi: Ndërtim
Profili: Punime dekorative dhe bojatisje
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	BOJATISJE NË SIPERFAQE PREJ TULLE E GURI	M-02-1815-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në punime bojatisje në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Ndërtim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësit kryejnë organizimin e vogël të punës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të zbatojnë legjislacionin për punimet e ndërtimit;– të lexojnë dhe interpretojnë projektin, skicat dhe detaje të bojatisjes sipërfaqeve prej tulle e guri;– të planifikojnë bazën materiale, mjetet, veglat, instrumentet e punës të nevojshme;– të interpretojnë radhën e punës të bojatisjes së sipërfaqeve prej tulle e guri sipas kushteve teknike në mjedise të brendshme e të jashtme;– të ndajnë detyrat e punës sipas radhës;– të planifikojnë nevojën për burime njerëzore sipas grafikut të punimeve;– të plotësojnë dokumentacionin teknik;– të koordinojnë punën me grupet e punës të proceseve të tjera;– të identifikojnë nevojat për trajnim sipas teknologjive të reja në kryerjen e punimeve të bojatisjes së sipërfaqeve prej tulle e guri. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>RM 2 Nxënësit kryejnë punime parapërgatitore. Kriteret e vlerësimit: Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të veshin uniformën e punës dhe sigurojnë skelën;– të përgatisin vendin e punës, të për zgjedhin veglat, mjetet,	

- instrumentet dhe materialet e punës sipas proceseve të punës;
- të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të veglave, mjeteve, instrumenteve të punës sipas manualit të përdorimit;
 - të sigurojnë ndriçim dhe ajrosjen e duhur të vendit të punës;
 - të kontrollojnë sipërfaqet prej tulle e guri që do të bojatisen (qemer, mur, davançal, shtyllë, fasade, etj.);
 - të mbulojnë me letër mbrojtëse sipërfaqet që nuk do bojatisen;
 - të lajnë me ujë me presion sipërfaqen prej tulle e guri duke hequr pluhurat;
 - të pastrojnë me furçë metalike fugat nga myku dhe papastërtitë e tjera;
 - të lyejnë fugat me primer akrilik me vegla dore;
 - të kryejnë riparimin e sipërfaqeve prej tulle e guri;
 - të përgatisin stukon rezistente ndaj lagështisë e mykut duke respektuar kohën e duhur;
 - të stukojnë vendet e riparuar dhe fugat në sipërfaqet prej tulle e guri;
 - të interpretojnë teknikat të ndryshme që përdoren për bojatisjen e sipërfaqeve prej tulle e guri;
 - të pastrojnë paraprakisht vendin e punës;
 - të përgatisin bojën duke respektuar kohën e duhur për sipërfaqe tulle e guri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësit kryejnë bojatisje në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përziejnë pa ujë bojën vernik akrilik për sipërfaqe tulle e guri;
- të lyejnë me vegla dore (rul, furçë) sipërfaqet prej tulle e guri të brendshme e të jashtme;
- të lyejnë me llak vernik me bazë diluenti sipërfaqet prej tulle e guri;
- të lyejnë me bojën liquid me makineri sipërfaqet prej tulle e guri të brendshme e të jashtme;
- të kontrollojnë me kujdes cilësinë e bojatisjes të realizuar duke zbatuar kushtet teknike;
- të riparojnë sipërfaqet ekzistuese të patinuara sipas kushteve teknike;
- të heqin letrën mbrojtëse në sipërfaqet prej tulle e guri;
- të zbatojnë rregullat e higjienës personale në punë;
- të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjate punimeve;

- të pastrojnë vendin e punës, mirëmbajnë mjetet, makineritë e punës pas lyerjes sipërfaqeve prej tulle e guri;
- të sistemojnë vendin e punës dhe hermetizojnë bojrat pas lyerjes sipërfaqeve prej tulle e guri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në objekt ndërtimi dhe repartin e ndërtimit

Mësuesi i praktikës, duhet të përdorë demonstrime konkrete të proceseve për punimin e bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për analizimin, planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, parapërgatitjen e vendit të punës për punimet e bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për bojatisje me bojra të ndryshme në sipërfaqe tulle e guri të brendshme e të jashtme duke u mbikëqyrur nga mësuesi i praktikës për respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit, MKZ dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve matëse e niveluese.
- Nxënësit duhet të angazhohen në detyra administrative e tregtare lidhur me lyerjen e sipërfaqeve prej tulle e guri.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike në analizimin, planifikimin dhe organizimin e vogël të punës, parapërgatitjen e vendit të punës, bojatisjen me bojra të ndryshme në sipërfaqe tulle e guri të brendshme e të jashtme si dhe detyra administrative e tregtare.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, dokumentacione, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pune ndërtimi dhe objekt ndërtimi
 - Dokumentacioni teknik: urdhër pune, akte kontrolli, projekt zbatimi, detaje, skica, udhëzues dhe manuale përdorimi, udhëzues për zbatimin e rregullave sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.
 - Pankarta për punime bojatisje në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri.
 - Mjetet, instrumentet matëse e niveluese.
 - Komplet i veshjes bojaxhiut.
 - Materialet për bojatisje:
 - Llak vernik me bazë diluenti,
 - Bojra liquid të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme,
-

-
- Stuko të ndryshme,
 - Primer të ndryshme,
 - Mjete pune: furçë metalike, rul dore, furçë boje, kovë, govatë bojaxhiu, leckë pastrimi, mallë dore, shpatull dore, mekanizëm/kompresor për lyerje, zorrë uji me presion, fshesë, etj
 - Letër mbrojtëse për ambjente
 - Kimikate për pastrues boje
-